



Nr. i Protokollit 01-1149/A

Data 29.11.2022

Në bazë të dispozitave të nenit 21, të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), nenit 23 paragrafi 23.3.6 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore nr.01-797/1 dt.03.08.2022, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i NPB-re në mbledhjen e mbajtur më datë: 25.11.2022 mori këtë:

VENDIM

- I. Në pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A. me seli në Prishtinë, përzgjedhët z. Arton Berisha-jurist i Diplomuar.
- II. Paga e Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. në Prishtinë, caktohet në bazë të dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, në përputhje me Shtojcën 01-365/1 e datës 24.03.2022.
- III. Kryeshefi Ekzekutiv i përzgjedhur sipas pikës I të këtij vendimi do të themelojë marrëdhënie kontraktuale pune nga dt.01.12.2022.
- IV. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore t'i kryejë të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren nr.01-179/1 datë 08.02.2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin me përshkrim të detyrave të punës të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. Prishtinë.

Arsyetim

Në bazë të konkursit të shpallur me datën 21 tetor 2022 në web faqen zyrtare të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe në mediat elektronike, për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore, kanë aplikuar 8 kandidatë, nga të cilët 7 kandidatë i kanë plotësuar kriteret e konkursit për të vazhduar në fazën e intervistimit.

Tabelë. Kandidatët e intervistuar dhe poentimi i tyre

	Kandidati	Rezultati
1	Arton Berisha	364
2	Bashkim Beha	336
3	Arsim Rashiti	193
4	Arben Shabani	170
5	Besim Osmani	166
6	Arton Jusufi	139
7	Shpejtim Nishori	88

Bordi i Drejtorëve ka bërë vlerësimin e kandidatëve në bazë dokumentacionit të dorëzuar dhe pas procedurës së intervistimit ka nxjerrë listën përfundimtare të poentimit duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë procedurën e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi.

Inicimi i procedurës të konfliktit administrativ nuk e pezullon ekezkutimin e këtij vendimi

Ky vendim i dorëzohet:

- Të përzgjedhurit
- Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve
- Burimeve Njerëzore
- Arkivit të Ndërmarrjes

Muhamet Gubetini Kryesues

